



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.74 , datë 18.12.2014

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KREDINË BRENDA DITËS PËR
BANKAT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja òbò, të neneve 15, 16, 17 dhe nenit 43, shkronja òcò, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, òPër Bankën e Shqipërisëò, i ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, òPër bankat në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren òPër kredinë brenda ditës për bankatò, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi dhe të rregullores òPër kredinë brenda ditës për bankatò në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe dërgimin e saj pranë bankave.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Rregullorja òPër kredinë brenda ditës për bankat tregtareò, miratuar me vendimin nr. 92, datë 30.11.2005, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të Rregullores òPër funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)ò.

SEKRETARI

Elvis Çibuku

ZËVENDËSKRYETARI

Elisabeta Gjoni

RREGULLORE

“MBI KREDINË BRENDË DITËS PËR BANKAT”

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve për dhënien e kredisë brenda ditës për të plotësuar nevojat e bankave për likuiditet brenda ditës dhe për të garantuar vijueshmërinë normale të funksionimit të sistemit ndërbankar të pagesave.

Neni 2 Përkufizime

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) **Autorizim**- është pranimi nga ana e Bankës së Shqipërisë për dhënien e kredisë;
 - b) **Bankë** - është personi juridik sipas ligjit për bankat në Republikën e Shqipërisë;
 - c) **DVP cut-off** ó është procedura e realizuar në sistemin AFISaR për mbylljen e shërbimit për shlyerjen e instruksioneve të pagesave DVP;
 - d) **Kredi** - është kredia brenda ditës. Një instrument nëpërmjet të cilit Banka e Shqipërisë u jep likuiditet bankave për të lehtësuar rrjedhën e pagesave në sistemin e pagesave ndërbankare AIPS. Bankat e kthejnë këtë kredi brenda ditës së punës, në përputhje me oraret e sistemeve të pagesave të Bankës së Shqipërisë;
 - e) **Lëvrim** - është disbursimi i kredisë në llogarinë e bankës;
 - f) **Sistemi AFISaR** - është sistemi qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes të titujve të shtetit shqiptar dhe të Bankës së Shqipërisë, që administrohet nga Banka e Shqipërisë;
 - g) **Sistemi AIPS** - është sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe, që administrohet nga Banka e Shqipërisë;
 - h) **Rregullore e sistemit AFISaR** ó është rregullorja e Bankës së Shqipërisë për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)ó.
2. Termat e tjerë kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimeve në aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3 Forma e kredisë

Kredia lëvrohet në formën e një marrëveshje riblerjeje.

Neni 4 Monedha dhe interesi i kredisë

1. Kredia autorizohet dhe lëvrohet vetëm në Lekë.
2. Banka e Shqipërisë nuk aplikon interes për kredinë.

Neni 5

Garantimi i kredisë

1. Kredia brenda ditës është kredi plotësisht e garantuar, si mjete për garantimin e së cilës përdoren titujt në Lekë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
2. Masat e kontrollit të rrezikut për vlerësimin e titujve të vendosur garanci janë të përcaktuara në rregulloren e Mbi garancitë në operacionet e kreditimit të Bankës së Shqipërisë.
3. Pas aplikimit të masave të kontrollit të rrezikut, llogaritet vlera e pranueshme e titullit të vendosur garanci. Kredia që i akordohet bankës është e barabartë ose më e vogël se vlera e pranueshme e titullit të vendosur garanci.
4. Vlera e pranueshme e titullit llogaritet sipas formulës në Shtojcën 1, pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kushtet për akordimin e kredisë

Bankat që kërkojnë kredi brenda ditës duhet të:

- a) të kenë llogari në sistemin AIPS;
- b) të kenë llogari në sistemin AFISaR;
- c) të kenë nënshkruar kontratën tip për riblerjen e titujve me Bankën e Shqipërisë; dhe
- d) të zotërojnë instrumentet e pranuar si garanci për kredinë, në përputhje me nenin 5, pika 1.

Neni 7

Aplikimi për kredi

1. Aplikimi për kredinë brenda ditës bëhet nga bankat në sistemin AFISaR, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e sistemit AFISaR.
2. Bankat mund të aplikojnë për një ose më shumë kredi brenda ditës gjatë kohës së lejuar për këtë operacion në rregulloren e sistemit AFISaR.

Neni 8

Autorizimi i kredisë

1. Çdo aplikim i bankave për kredi brenda ditës duhet të autorizohet nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e bankave për kredi brenda ditës, në përputhje me objektivat e saj dhe pa dhënë shpjegime.

Neni 7
Lëvrimi i kredisë

1. Kredia lëvrohet në llogarinë e bankës në sistemin AIPS dhe ripaguhet nga kjo llogari në përfundim të përdorimit të saj brenda ditës së punës.
2. Në rast se kredia brenda ditës nuk është shlyer deri në kohën e përcaktuar në sistemin AFISaR për kthimin e kredisë, atëherë Banka e Shqipërisë kontakton bankën për të akorduar kredi njëditore në përputhje me rregulloren e saj për kredisë njëditore. Kredia njëditore akordohet me një titull garanci të ndryshëm nga ajo e kredisë brenda ditës.
3. Në rast se në DVP cut-off të sistemit AFISaR, kredia brenda ditës nuk është shlyer, titulli i vendosur garanci për kredisë brenda ditës mbetet në llogarinë e Bankës së Shqipërisë dhe veprohet në përputhje me përcaktimet në kontratën tip për riblerjen e titujve të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Elisabeta Gjoni

Zëvendëskryetar i Këshillit Mbikëqyrës

Shtojca 1. Vlera e pranueshme e titullit

$$Vlera = \frac{(1 - H) * V_t * V_n}{1 + Im}$$

ku,

***H* (Marzhi reduktues)** ó i referohet përqindjes së caktuar që i zbritet vlerës së tregut të titullit. Kjo përqindje reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tillë si maturimi i mbetur, rreziku i kreditit të emetuesit, likuiditeti i titullit.

***V_t* (Vlera e tregut)** ó është çmimi i llogaritur i titullit në bazë të yield-it të tregut të përlllogaritur në mungesë të kuotimeve nga kurba e yeldeve dhe në bazë të formulës së përcaktimit të çmimit të njoftuar nga emetuesi ose në bazë të standardeve ndërkombëtare.

***Im* (Marzhi fillestar)** ó Banka e Shqipërisë kërkon që garancia e vendosur nga banka të jetë e barabartë me shumën e kredisë së akorduar, plus një përqindje të caktuar. Kjo përqindje e caktuar është marzhi fillestar.

***V_n* (Vlera nominale)** ó vlera nominale e titullit që do të përdoret për të garantuar kredinë brenda ditës.